

**QENDRA E STUDENTËVE E
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**
STUDENT'S CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
NË PRISHTINË - IN PRISHTINA

Marrë nga: 25.11.2025

Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
04	1133	7	—



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

Nr. 01-4968 DALJE
Data Datum Dat: 24.11.2025

Nr. 8
Prishtinë - Pristina - Pristina

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/

*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education,
Science, Technology and Innovation*

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Nr. 01-179
Dt. 24.11.2025

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10, 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nën paragrafit 1.13 të paragrafit 13 të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 14 / 9 shtator 2011, Prishtinë), si dhe në mbështetje të paragrafit 1.5 të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 34/18 nëntor 2022), nxjerr:

STATUTI I QENDRËS SË STUDENTËVE

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i Statutit të Qendrës së Studentëve (më tutje QS-së) është ofrimi i shërbimeve për studentët e Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina" në Prishtinë, si: strehimi, ushqimi, shërbimet e jetës kulturore, sportive dhe rekreative zbavitëse për student.

Neni 2 Themelimi

Qendra e Studentëve (në tekstin e mëtejshëm, Qendra e Studentëve), është themeluar në bazë të Vendimit të Këshillit Ekzekutiv të KSAK nr. IV –3444, datë 20.07.1960.

Neni 3 Emërtimi

1. Emri i Qendrës së Studentëve në gjuhën shqipe është: Qendra e Studentëve në Prishtinë.
2. Emri i Qendrës së Studentëve në gjuhën angleze është: Students Centre.
3. Emri në gjuhën serbe është: Studentski centar.

Neni 4 Selia

Selia e Qendrës së Studentëve gjendet në këtë adresë: rruga "Agim Ramadani" p.nr. Prishtinë.

Neni 5 Statusi i Qendrës së Studentëve

1. Qendra e Studentëve është institucion publik jofitimprurës me cilësi të personit juridik, me të drejta dhe detyra të përcaktuara në këtë statut dhe me ligjet në fuqi, duke përfshirë të drejtën për të paditur dhe për tu paditur.
2. Qendra e Studentëve është institucion nën vartësin e Ministrisë për Arsimit, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion, me mundësi të pavarësimit si njësi funksionale dhe program buxhetor i veçantë.

Neni 6 Shfrytëzimi dhe menaxhimi i pronave

Shfrytëzimi dhe menaxhimi i pronave dhe ndërtesave bëhet në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 7 Simbolet

1. Qendra e Studentëve ka këto simbole:

- 1.1 Stemën dhe**
- 1.2 Flamurin.**

2. Simbolet e Qendrës së Studentëve propozohen nga drejtori i përgjithshëm i QS-së, dhe miratohen nga i ministrisë përkatëse për arsim - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Neni 8 Vulat

1. Qendra e Studentëve ka vulën e rrumbullakët, vulën katërkëndëshe dhe vulat tjera zyrtare.

2. Format dhe dimensionet e vulave:

2.1. Vula e rrumbullakët e Qendrës së Studentëve me dimensione 28mm.

2.2. Vula katërkëndëshe me dimensione 55mm X 23mm.

3. Vulat tjera zyrtare: Numri, forma, dimensionet dhe përmbajtja e vulave tjera zyrtare përcaktohet me vendim të veçantë nga drejtori i përgjithshëm i QS-së, dhe miratohen nga MASHTI.

4. Përdorimi dhe ruajtja e vulave bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë e Qendrës së Studenteve

1. Qendra e Studentëve ka të drejtat dhe përgjegjësitë si vijon:

- 1.1. Të veprojnë në ofrimin e shërbimeve cilësore për studentë;**
- 1.2. Të ndihmojnë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;**
- 1.3. Të synojnë krijimin dhe mbështetjen e standardëve me të larta në fushën e përgjegjësisë të Qendrës së Studentëve;**
- 1.4. Të shfrytëzojnë burimet e veta në mënyrë sa më efektive;**
- 1.5. T'u përshtatet standardeve evropiane;**
- 1.6. Të zhvillojnë dhe zbatojnë strategjitë e ofruara nga MASHTI;**
- 1.7. Propozimin dhe pranimin e tarifave;**
- 1.8. Punësimin dhe shkarkimin e personelit për arsye ligjore;**
- 1.9. Nënshkrimin e kontratave për mallra dhe shërbime dhe kapitale;**

- 1.10. Vendosjen për përmbajtjen dhe strukturën e programeve punuese, artistike dhe profesionale;
- 1.11. Vendosjen e marrëdhënieve juridike me studentët dhe përcaktimin e kushteve për strehimin e studentëve;
- 1.12. Aplikimi i masave të duhura për vlerësim dhe sigurim të cilësisë së shërbimeve;
- 1.13. Nënshkrimin e marrëveshjeve me bartësit vendor dhe ndërkombëtar brenda përgjegjësisë të përcaktuara në Qendrën e Studentëve;
- 1.14. Detyrat tjera të nevojshme për kryerjen e funksionit të Qendrës së Studentëve në pajtim me këtë statut;
- 1.15. Të rregulloj strukturat dhe aktivitetet e saj përmes rregullave të Qendrës së Studentëve në përputhje me ligjet në fuqi dhe aktet tjera të nxjerra nga këto ligje, bazuar në dispozitat e këtij statuti;
- 1.16. Të zgjedhë personelin e Qendrës së Studentëve, të përcaktoj kushtet për pranimin e studentëve përfitues nga shërbimet e ofruara nga Qendra e Studentëve;
- 1.17. Të zhvilloj dhe zbatojë plan-programet dhe projektet e punës në pajtim me këtë statut dhe me legjislacionin në fuqi.

Neni 10 **Shërbimet në Qendrën e Studentëve**

1. Qendra e Studentëve ofron shërbime në këto fusha:
 - 1.1. Konvikte për studentë;
 - 1.2. Mensë për ushqimin e studentëve;
 - 1.3. Pajisje dhe objekte për rekreacionin e studentëve;
 - 1.4. Pajisje dhe objekte për kulturë dhe argëtim të studentëve;

Neni 11 **Struktura Organizative**

1. Mënyra e funksionimit, qeverisjes dhe menaxhimit të QS-së.
2. Qendra e Studentëve udhëhiqet/menaxhohet nga: kjo Strukturë Organizative :
 - 2.1. Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve;
 - 2.2. Drejtorët e Departamenteve (niveli i mesëm drejtues);
 - 2.3. Udhëheqësit e Divizioneve (niveli i ulët drejtues).
3. Njësitë tjera menaxhuese rregullohen me akte të brendshme për sistematizim në QS-së.

Neni 12
Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve

1. Drejtori i përgjithshëm është nëpunës Publik, i zgjedhur dhe emëruar në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik të Republikës së Kosovës.
2. Drejtori krahason detyrave të përcaktuara me ligj, kryen edhe këto punë:
3. Drejtori i përgjithshëm ka këto kompetenca:
 - 3.1. Udhëheq dhe përfaqëson Qendrën e Studentëve dhe kujdeset për ligjshmërinë e veprimtarisë dhe të organeve të saj;
 - 3.2. Bashkërendon punën me Ministrinë dhe me institucione të tjera relevante;
 - 3.3. Është urdhëruar dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar dhe planit të punës të Qendrës së Studentëve;
 - 3.4. Mbikëqyr rekrutimin e stafit dhe vlerësimin e punës: Shpall konkurset për vendet e punës dhe përkujdeset për zhvillimin e procedurave sipas ligjit;
 - 3.5. Nënshkruan kontratat e punës dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen procedurale sipas ligjit dhe këtij Statuti;
 - 3.6. Nënshkruan dokumentet e Qendrës së Studentëve të cilat kanë karakter të akteve të veçanta;
 - 3.7. Nënshkruan kontrata me palën e tretë në bazë të kompetencave të tij;
 - 3.8. Siguron zbatimin e mbrojtës në punë dhe mbrojtës nga zjarri;
 - 3.9. Nxjerr akte nënligjore në përputhje me këtë Statut dhe Ligjet përkatëse;
 - 3.10. Vendos për nevojat për furnizim të Qendrës së Studentëve me mjete themelore dhe inventar; për aq sa e ka të lejuar me kompetenca;
 - 3.10. Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve për punën e vet, në aspektin administrativ dhe në aspektin funksional i raporton Ministrisë, së MASHTI-t;
 - 3.11. Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Marrëdhënia e punës së Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Studentëve

Marrëdhënia e punës së drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për zyrtarët publik dhe akteve tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 14

Financimi

1. Qendra së Studentëve financohet nga këto burime:

1.1. Nga buxheti i MASHTI-t;

1.2. Nga të hyrat vetanake;

1.3. Donacionet e ndryshme;

1.4. Nga burimet tjera ligjore;

2. Të hyrat vetanake të Qendrës së Studentëve janë:

2.1. Pagesat nga strehimi i studentëve;

2.2. Pagesat e ushqimit;

2.3. Pagesat nga qiratë;

2.4. Pagesat nga palestra e sporteve;

2.5. Burime tjera ligjore.

Neni 15

Menaxhimi Financiar

1. Menaxhimi i buxhetit të Qendrës së Studentëve bëhet nga drejtori i përgjithshëm i QS-së, duke respektuar kufijtë buxhetor nga ministria përgjegjëse për financa dhe MASHTI, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligjin për MFPP dhe aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë fushë.
2. Realizimi i mjeteve vetanake rregullohet me akt të veçante të propozuar nga Qendra e Studentëve dhe të miratuar nga Sekretari-ja, i përgjithshëm i MASHTI-t, dhe Ministria e Financave.

Neni 16

Ruajtja dhe mbajtja e dokumentacionit financiar

1. Qendra e studenteve duhet të mbajë dokumentacionin përkatës financiar mbi të hyrat vetanake si dhe mënyrën e shpenzimeve të tyre, në përputhje me ligjet dhe aktet tjera nënligjore të kësaj fushe.
2. Mbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit financiar është përgjegjësi e drejtorit të departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme në Qendrën e Studentëve.
3. Mbikëqyrjen në mirëmbajtje dhe ruajtje të dokumentacionit financiar e bënë drejtori përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.
4. Njësia e prokurimit të Qendrës së Studentëve është e obliguar që të udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.
5. Rishikimi i buxhetit të Qendrës së Studentëve bëhet çdo gjashtë muaj.
6. Mbikëqyrja financiare bëhet nga auditori i MASHTI-t, dhe nga auditori i përgjithshëm.

Neni 17

Dispozitat Kalimtare

1. Nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Drejtori i Përgjithshëm i QS-së, obligohet që të bëjë harmonizimin e akteve tjera nënligjore me këtë Statut.
2. Zyrtarët kryesor: drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, udhëheqësit e divizioneve dhe të gjithë punëtorët tjerë, marrëdhëniet e punës i rregullojnë në pajtim me këtë Statut, Ligjin për Zyrtarët Publik dhe Ligjin e Punës.
3. Të gjitha programet e punës që janë duke u zbatuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti konsiderohen të aprovuara.

Neni 18

Dispozitat Shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti të Qendrës së Studentëve, shfuqizohet Statuti i Qendrës së Studentëve i Universitetit të Prishtinës, Nr.01B/2625 i datës 05.05.2017.

Neni 19
Hyrja në Fuqi

Ky Statut hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.


Arbërie Nagaveci


Ministre në detyrë e Ministrisë për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion